



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201502720/2

Tiranë ____/____/2016

Lënda : *Rekomandohet moskryerja e veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të Titullit E kzekutiv, (Akt marrje kredie) nr.140476016, datë 30.09.2010, për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit me Vendimin Nr. 5233 Akti, datë 10.10.2011, mbi të ardhurat mujore të ankueses M.B.*

Drejtuar : **Jordisa Dervishi**
Përmbaruese Gjyqësore pranë Shoqërisë Përmbarimore "Star" Sh.p.k.
Adresa : Bulevardi "Zogu i I", Rruga "Maliq Muço",

TIRANË

Për dijeni; Ministrisë së Drejtësisë

**Dhomës Kombëtare të Shërbimit të Përmbarimit
Gjyqësor**

TIRANË

Znj/Zj.Përmbaruese gjyqësore!

Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar për shqyrtim ankesën e shtetases Manjola Bregu, në të cilën prezantohet shqetësimi i kryerjes së veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv (Akt marrje kredie) nr.140476016, datë 30.09.2010, për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit me Vendimin Nr. 5233 Akti, datë 10.10.2011.

Sipas titullit ekzekutiv të lartpërmendur, rezulton se, ankuesja në cilësinë e debitores solidare nuk ka shlyer detyrimin në të holla në afatin e përcaktuar ndaj palës kreditore.

Nga aktet e vëna në dispozicion prej ankueses, rezulton se, ju, me rastin e përfundimit të afatit ligjor për dorëzimin në mënyrë vullnetare të detyrimit në të holla, me Shkresën nr.914 Prot, datë 28.09.2015, keni urdhëruar vendosja e masës së sekuestrës mbi pagën

e debitores pranë punëdhënësit të saj, e cila rezulton në masën 23.000Lekë në muaj, pra në kufirin minimal të përcaktuar në VKM nr. 573, datë 03.07.2013.

Duhet kuptuar, se, vendosja e kufirit minimal të pagës mujore sipas aktit ligjor të lartpërmendur, është kryer në funksion të sigurimit të mjeteve jetike për jetesë të një familjeje. Në këtë kuptim, paga e debitores, kur dhe i janë lenë sipas Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr. 7682, datë 04.07.2014, Të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, dy fëmijët për rritje dhe edukim, duhet konsideruar, dhe në referim të Direktivës së dhënë me shkresën Nr.46 Prot, datë 19.01.2015, prej Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësor Privat, si minimum jetik, kjo dhe në kuptim dhe zbatim të parashikimit të kryer në nenin 533 të K.Pr.C.

Në kushtet kur deri më sot nuk është mundësuar ende nxjerrja e aktit ligjor, i cili do të mundësoj përcaktimin e minimumit jetik nga ana e organit kompetent shtetërorë, Institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomandur organit përkatës marrjen e masave për përcaktimin e tij, me qëllim që, dhe veprimtaria e Shërbimit të Përmbaimit Gjyqësor të zhvillohet në mënyrë të rregullt e në respektim të të drejtës së njeriut.

Në këto kushte, ju si organ kompetent, me nismën tuaj, mund dhe duhet të moskryeni veprime përmbaimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të lartpërmendur mbi të radhurat mujore të ankueses të cilat rezultonë në masën 23.000Lekë në muaj.

Në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin thuhet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”*, si dhe nenit 21/b, se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*,

REKOMANDOJMË

Moskryerja e veprimeve përmbaimore për ekzekutimin e detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv, (Akt marrje kredie) nr.140476016, datë 30.09.2010, për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit me Vendimin Nr. 5233 Akti, datë 10.10.2011, mbi të ardhurat mujore të ankueses M.B.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Etilda GJONAJ(SALIU)

Konceptoi dhe Daktiligrafoi
A.Gjoleka